

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 2546 Rep.
Nr. 2546 Kol.

KONTRATË DHURIMI

Në Tiranë, sot më datë 12. 11. 1999 (nëntëdhjet e nëntë) para meje noteres **Lindita LLESHI** me adresë në Rrugën "Zhan D'Ark" pranë Gjykatës së Rrethit u paraqitën personalisht palët e kontratës së dhurimit me identitetet e mëposhtme:

DHURUES: **Xhezmi Ferri**, i biri i Çomos, datëlindja 1935, lindur në Luarë, banues në Kumanovë Fier, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nga pasaporta personale.

PRANUESI I DHURIMIT: **Arjan Kerri**, i biri i Xhezmiur, datëlindja 1966, lindur në Berat, banues në Kumanovë Fier, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me pasaportë nr. 0320062.

Bazuar në nenin 761 i Kodit Civil u kërkua nga palët kjo kontratë me përmbajtjen që vijon:

Me vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë, Nr. 8528 dt. 31. 01. 1997 është regjistruar si person juridik shoqëria "Kerri" Sh.p.k. me ortak të vetëm dhuruesin. Për krijimin e shoqërisë është derdhur kapitali themeltar 100 000 (njëqind mijë) lek. Këtë kapital themeltar ia dhuron djalit të tij Arjan Kerri, i cili do të jetë edhe ortak i vetëm i kësaj shoqërie në të ardhmen. Nga ana e tij Zoti Arjan Kerri e pranon pa asnjë kusht këtë dhuratë nga babai i tij.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate dhuruesi humbet të drejtën mbi këtë kapital duke i fituar këto të drejta pranuesi i dhurimit Arjan Kerri.

Kontrata pasi iu lexua me zë të lartë palëve, nuk pati vrejthe prej tyre, nënshkruhet rregullisht në prani të noteres.

Kjo kontratë u hartua në dy kopje origjinale të barsvlefshme me njëra-tjetrën, një kopje e të cilës depozitohet në këtë zyrë.

Unë Noterja pasi u binda për vullnetin e plotë të palëve bazuar në ligj vërtetoj nënshkrimet në këtë kontratë.

DHURUESIT
Xhezmi KERRI



PRANUESI I DHURIMIT
Arjan KERRI

